



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 (paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 31.10.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2432/13, për z. Engin Beyoglu – zv. kryesues në Kuvendin e Komunës së Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit, pasi që ka dhënë dorëheqje nga posti i zv. kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nr. AKK – 03-2432/13, për Zyrtarin e Lartë z. Engin Beyoglu – zv. Kryesues në Kuvendin e Komunës së Prishtinës dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat “Kent Fm Radyosu”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartpërmendur, zyrtari i lartë z. Beyoglu është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit. Pas kësaj, zyrtari në fjalë është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet të cilat duhet të bëj për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë z. Beyoglu, në këtë takim ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të shmangë konfliktin e interesit duke hequr dorë nga ushtrimi i funksionit të tij publik.

Ndërkohë, z. Beyoglu ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Kuvendi Komunal i Prishtinës (DPKI 03-3591/13) në të cilën vërtetohet se i njëjti ka dhënë dorëheqje nga posti i zv. kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, për të ushtruar veprimtarinë e tij private. Me këtë rast ai ka shmangur gjendjen mundshme të konfliktit të interesit.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

